



23 nëntor 2012, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA
Rregullorja për trajtimin e ndërtimeve pa leje – kopje anti-ligjore

Në kuadër të projektit të monitorimit të transparencës së ekzekutivit komunal të Prizrenit, EC Ma Ndryshe muajin e kaluar kishte reaguar në lidhje me defektet e hartimit dhe miratimit të Rregullores për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje nga ana e Kuvendit Komunal të Prizrenit.

EC Ma Ndryshe muajin e kaluar pat shprehur shqetësimin me praktikën e fundit të ekzekutivit dhe legjislativit të Prizrenit që një rregullore kaq e ndjeshme dhe e rëndësishme për zhvillimin e gjithëmbarshtëm të kaloj pa u vënë në sprovën e publikut, respektivisht pa u testuar nëse është në interesin e qytetarëve apo jo, përmes debatit të mirëfilltë publik.

Meqë kjo rregullore është sponsorizuar nga kryetari komunës, Ramadan Muja dhe duke marrë parasysh seriozitetin e këtij akti dhe fushën që e mbulon, sikurse edhe implikimet në punën e përditshme të qeverisë komunale, gjatë muajit nëntor, EC Ma Ndryshe ka hulumtuar në hollësi sfondin ligjor dhe praktikën e aplikuara nga komunat tjera, që ka rezultuar në nxjerrjen e konstatimit se: komunat e Republikës së Kosovës respektivisht komuna e Prizrenit nuk ka bazë të duhur ligjore për miratimin dhe zbatimin e një rregulloreje të tillë.

EC Ma Ndryshe në kuadër të këtij hulumtimi ka siguruar nga MAPL-ja “Raportin e komisionit të përbashkët MMPH-MAPL lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së Rregullores për trajtimin e ndërtimeve pa leje në komunën e Podujevës”, që sipas zyrtarëve të MAPL-së vlen edhe për komunat tjera që e kanë miratuar Rregulloren për trajtimin e ndërtimeve pa leje, pra edhe për Prizrenin.

Në raportin e komisionit thuhet se “Neni 37.1 i ligjit të Ndërtimit nr. 2004/15, i cili parasheh dokumentacionin e duhur për marrjen e lejes së ndërtimit nuk është bazë për nxjerrjen e kësaj rregulloreje”. Duhet cekur se rregullorja e KK-së së Prizrenit në mes tjerash është bazuar në nenet 36 dhe 37 të këtij Ligji.

Komisioni MMPH-MAPL për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave nga fusha e ndërtimit pas shqyrtimit të aspektit të kompetencave ligjore dhe të kundërshtimit me akte ligjore dhe nënligjore në fuqi të rregullores në fjalë ka dhënë këtë rekomandim:

“Kjo rregullore duhet të jetë rrjedhshmëri nga Ligji për trajtimin e objekteve pa leje apo të ndonjë akti nënligjor, i cili do të nxirrej nga institucionet e qeverisjes qendrore- dokumente këto të cilat nuk janë nxjerrë në shqyrtim. Dihet ligjërisht, që aktet nënligjore ose Rregulloret nxirren në bazë dhe në zbatim të një ligji çfarë nënkupton se ato janë një lloj zgjatimi i ligjit dhe mundet kurrsesi të bien ndesh apo të tejkalojnë urdhërimet e ligjit mbi të cilin bazohen”.

Vlen të theksohet se ky interpretim ligjor i Rregullores për trajtimin e ndërtimeve pa leje është dhënë në qershor të vitit të kaluar.

Gjatë hulumtimit EC Ma Ndryshe po ashtu ka gjetur se Rregullorja për trajtimin e ndërtimeve pa leje e KK-së së Podujevës e miratuar më 29 prill 2011 është pothuajse identike me atë të miratuar nga KK-ja e Prizrenit, më 18 tetor 2012.

Ndërkohë, EC Ma Ndryshe është njoftuar se Qeveria e Kosovës e ka hartuar Projektligjin për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, ku në Nenin 5 përcaktohen Përgjegjësitë e Komunave për legalizimin e ndërtimeve pa leje dhe ky dokument tashmë është në fazën e konsultimeve paraprake dhe publike, prandaj dhe komunat duhet të presin miratimin nga Kuvendi i Kosovës.

Bazuar në këto të dhëna EC Ma Ndryshe rekomandon MAPL-në që në afatin sa më të shpejtë të anuloj Rregulloren për trajtimin e ndërtimeve pa leje të miratuar nga KK-ja e Prizrenit më 18 tetor 2012, meqë i njëjti është hartuar pa bazë të duhur ligjore;

EC Ma Ndryshe rekomandon edhe kryetarin e komunës së Prizrenit që të jetë më i kujdesshëm dhe më i përgjegjshëm gjatë propozimit të Rregulloreve që kanë ndikim të madh në jetën e qytetarëve, urbanizmin dhe të ardhmen e komunës;

EC Ma Ndryshe po ashtu kërkon që të ndërpritet praktika e kopjimit të Rregulloreve apo vendimeve të komunave tjera, në mënyrë që secili akt apo dokument që propozohet nga kryetari apo organet tjera komunale të Prizrenit të jenë në përputhje me nevojat, kërkesat dhe interesat e qytetarëve të komunës së Prizrenit;

Gjithashtu EC Ma Ndryshe i bën thirrje anëtarëve dhe kryesuesit të Kuvendit Komunal që të jenë në nivel të detyrës, të kryejnë funksionin e kontrolluesit të ekzekutivit dhe të jenë më rigoroz në respektim të ligjit, duke refuzuar miratimin e akteve që nuk kanë bazë ligjore .

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,
Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

Projekti "Transparenca online e komunës së Prizrenit" prej muajit shtator 2012 përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.